



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 11.05.2023

Nr: 92

Ora: 13:45

VENDIM

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 54, DATË 08.05.2023, DEPOZITUAR NGA “PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 11.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvin LAKO - **Relator**

Elvis ÇEFA - **Anëtar**

Ilirjan RUSMALI - **Anëtar**

Koli BELE - **Anëtar**

Ledio BRAHO - **Anëtar**

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: “Partia Socialiste e Shqipërisë”, përfaqësuar nga z. Maringlen Legisi;

OBJEKT: Kundërshtimin e vendimit nr. 455, datë 06.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 386 nga KRIIK për afishimin e materialeve propagandistike në

kundërshtim të ligjit nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” në aksin rrugor kombëtar Tiranë Lushnjë”.

BAZË LIGJORE:

Nenet 21, pika 1, shkronja “b”, dhe 123/1, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Rrethanat e çështjes:

1. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është administruar denoncimi me denoncues Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), regjistruar me nr. 386 ID të regjistrimit të denoncimeve. Nëpërmjet këtij denoncimi pretendohet se “Në aksin rrugor kombëtar nga Tirana në Lushnjë, përkatësisht në bashkitë Lushnjë, Rogozhinë, Kavajë dhe Durrës, janë afishuar materiale propagandistike në kundërshtim të ligjit nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

Në përgjigje të këtij denoncimi, KQZ ka filluar hetimin administrativ përkatës, duke i kërkuar informacion monmonitoruesve të caktuar nga KQZ për monitorimin e bashkive të sipërcituara. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) ka marrë vendimin nr. 455, datë 06.05.2023, ku ka vendosur ‘Urdhërimin e Policisë Bashkiake dhe Policisë së Shtetit për heqjen e menjëherëshme të materialeve propagandistike të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” të vendosura në aksin rrugor kombëtar nga Tirana në Lushnjë, respektivisht në bashkitë Tiranë, Durrës, Rogozhinë, Kavajë dhe Lushnjë.’

2. Kundër këtij vendimi ka paraqitur kërkesë ankimore subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë ku pretendon se:
 - Ekziston një paqartësi për shkak të mospërputhjes së shkëljes së pretenduar dhe bazës ligjore të përdorur nga KSHZ për të bazuar vendimin e tij;
 - Vendimi i marrë nga KSHZ është bërë duke iu referuar fakteve jo ekzistente dhe duke cenuar të drejtat e subjekteve zgjedhore gjatë fushatës;
 - Në posterat reklamues është vendosur shënimi “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të Partisë Socialiste të Shqipërisë”, në përputhje me përcaktimin e pikës 3 të nenit 79 të Kodit Zgjedhor, si

dhe të pikës 1 të nenit 3 të Udhëzimit nr. 06, datë 23.03.2021 të KSHZ “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”.

3. Seanca e datës 11.05.2023 u zhvillua me praninë e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, si përfaqësues i Komisionerit, specialistëve të administratës së KQZ-së dhe palës ankuese me përfaqësues z. Maringlen Legisi.
4. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
 - Vendimin nr. 455, datë 06.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 386 nga KRIIK për afishimin e materialeve propagandistike në kundërshtim të ligjit nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” në aksin rrugor kombëtar Tiranë Lushnjë”.
 - Kërkesën ankimore nr. 54, datë 08.05.2023;

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

KAS-i konstatoi:

1. Me vendimin nr. 455, datë 06.05.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka urdhëruar heqjen e menjëhershme të materialeve propagandistike të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” të vendosura në aksin rrugor kombëtar nga Tirana në Lushnje, respektivisht në bashkitë Tiranë, Durrës, Rrogozhinë, Kavajë dhe Lushnje.
2. Gjatë fazës së parë të shqyrtimit administrativ pranë KSHZ, monitoruesit e caktuar nga KQZ për monitorimin e bashkive të sipërcituara, kanë paraqitur informacionin pranë KQZ se materialet propagandistike janë të vendosura në këto akse rrugore dhe nuk përmbajnë shënimin “prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të...”.
3. Gjatë fazës së shqyrtimit administrativ pranë KAS, përfaqësuesi i subjektit ankues paraqiti si provë materiale disa pamje fotografike të posterave ku dallohej mbi to shënimi “Prodhuar

nën përgjegjësinë ligjore të Partisë Socialiste të Shqipërisë”, ku pretendoi gjithashtu se në momentin kur Policia Bashkiake ka shkuar për të verifikuar dhe për të hequr materialet propagandistike, posterat e kanë patur këtë shënim dhe për këtë arsye nuk janë hequr nga Policia.

4. Nisur nga këto fakte, duke qenë se në momentin e marrjes së vendimit nr. 455, datë 06.05.2023, posterat nuk e kanë patur shënimin “prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të...”, por gjatë verifikimit rezultoi se këto postera e përmbajnë shënimin përkatës, KAS çmon të arsyeshme të ndryshojë vendimin e KSHZ duke shtuar në pikën 1 të dispozitivit të vendimit fjalët “të cilat nuk përmbajnë shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të Partisë Socialiste të Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 143, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës ankimore të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
2. Ndryshimin e pikës 1 të vendimit nr. 455, datë 6.5.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 386 nga KRIIK për afishimin e materialeve propagandistike në kundërshtim të ligjit nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” në aksin rrugor kombëtar Tiranë Lushnjë”, duke e riformuluar si më poshtë : Urdhërimin e Policisë Bashkiake dhe Policisë së Shtetit për heqjen e menjëherëshme të materialeve propagandistike të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” të vendosura në aksin rrugor kombëtar nga Tirana në Lushnjë, respektivisht në bashkitë Tiranë, Durrës, Rrogozhinë, Kavajë dhe Lushnjë, të cilat nuk përmbajnë shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të Partisë Socialiste të Shqipërisë”.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1, të nenit 145 të Kodit Zgjedhor mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të tij.

U shpall sot më datë 11.05.2023.

Elvin LAKO - **Relator**

Elvis ÇEFA - **Anëtar**

Ilirjan RUSMALI - **Anëtar**

Koli BELE - **Anëtar**

Ledio BRAHO - **Anëtar**